



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 669/1 Prot.

Tiranë, më 22 . 06 . 2023

**V E N D I M**

**Nr. 112 , datë 22 . 06 . 2023**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 114 Regj., datë 09.06.2023, të shtetasit B. P, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjeve fetare” dhe “çdo shkak tjetër<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, në shpjegimet e paraqitura para Komisionerit, është shprehur se, në muajin nëntor të vitit 2016 është ndaluar nga Policia e Shtetit me akuzën për tentativë të kryerjes së akteve terroriste, dhe se është mbajtur në ambientet e paraburgimit në tejkallim të afateve të parashikuara në ligj. Më pas ankuesi citon se, është mbajtur në arrest me burg për një vit dhe dy vite në arrest shtëpie. Në vijim, shpjegon se në vitin 2020, nga gjykata është pushuar çështja penale në ngarkim të tij, pasi nuk kishte asnjë provë që e lidhte me rastin për të cilin ishte akuzuar.

Ankuesi pretendon se diskriminohet nga nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (në vijim referuar me akronimin DPPSH) pasi nga ana e saj janë hedhur në sistemin TIMS, të dhëna për personin e tij, të cilat shërbejnë si indicie për strukturat e Policisë së Kufirit, që ndaj tij të ushtrojnë kontrolle të imtësishme, verifikime, ndalime etj. Ankuesi pretendon se diskriminohet pasi ai nuk figuron i dënuar, dhe në vijim citon se:

<sup>1</sup> Pa përcaktuar, shpjeguar apo dokumentuar se çfarë pretendon a justifikon ankuesi me këtë shkak.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

*“Kam bërë disa hërë kërkesë drejtuar DPPSH për fshirjen e gjurmëve të lëna në TIMS, qofshin ato ndaluese apo verifikuese, pasi unë nuk kam asnjë masë ndaluese sipas legjislacionit në fuqi. Rasti më i fundit ka qenë me datë 10.12.2022, kur jam ndaluar në Pikën Kufitare Rinas dhe jam mbajtur për verifikim për rreth një orë, e më pas e njëjta situatë ka vijuar edhe në destinacion, në aeroportin e Ankonës, Itali, ku dhe aty jam mbajtur për kontrolle të hollësishme dhe verifikime të detajuara, ku në vlerësimin tim ishin të sinjalizuara nga Shqipëria. Kërkoj të më fshihen të gjitha shënimet nga TIMS pasi unë nuk jam as i ndaluar, as rrezik ikje. Çështja penale ndaj meje ka pushuar dhe unë vazhdoj të kem probleme në lëvizjen për jashtë vendit si dhe në punësim, gjë që ka sjellë pasoja familjare, ekonomike dhe psikologjike tek unë”.*

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri: *“Të ndalohet diskriminimi ndaj meje dhe të jetoj i lirë si çdo qytetar tjetër”.*

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga ana e palës ankuese, rezulton e provuar<sup>3</sup> se, ndaj shtetasit B. P, Gjykata e Posaçme për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar të Shkallës së Parë, ka pushuar çështja penale të regjistruar me nr. 333/1, të vitit 2015<sup>4</sup> dhe se ai figuron si person me gjendje gjyqësore i padënuar.

Subjekti ankues ka pretenduar se si shkak për veprimet diskriminuese ndaj tij nga ana e DPPSH dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, kanë shërbyer bindjet e tij fetare.

Në shpjegimin që Komisioneri bën për shkaqet e përfshira në listën jo shteruese të shkaqeve të diskriminimit<sup>5</sup>, lidhur me bindjet fetare ka përkufizuar se: *“Bindja fetare mbulon shprehjen e besimit fetar ose besimin e zgjedhur nga individi përfshirë edhe mos shprehjen e besimit, të cilat mund të manifestohen privatisht ose publikisht në vende kulturi, rite dhe mësimet fetare”*.

Në kontekst të provueshmërisë së këtij shkak të pretenduar, Komisioneri vëren se, nga këqyrja e akteve të depozituara nga ankuesi, ky shkak rezulton i provuar prej tij, pasi besimin fetar e ka të shprehur dhe manifestuar publikisht, duke cituar si më poshtë:

Bazuar në Vendimin nr. 26, datë 20.05.2020, të Gjykatës së Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, ndër të tjera, evidentohet se ankuesi dyshohej për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste, duke u konsideruar si anëtar i një grupi terrorist i cili po planifikonte të kryente sulme terroriste gjatë ndeshjes së futbollit mes Izraelit dhe Shqipërisë, në stadiumin “Loro Boriçi”, në Shkodër me datë 12.11.2016.

Në përmbajtje të vendimit citohet se ankuesi së bashku me disa persona të tjerë të përfshirë në këtë hetim janë mbajtur nën vëzhgim, si dhe janë kryer veprimet e këqyrjeve të rrejteve sociale të tyre, ku konstatohet përkrahja virtuale e tyre për ekstremizmin dhe organizatat terroriste ISIS.

Në vendim citohet ndër të tjera se, ankuesi dhe personat e tjerë të dyshuar, të përfshirë në këtë gjykim, janë të njohur me njëri-tjetrin pasi i lidh vllazëria myslimane, kryejnë ritualet e faljes tek Xhamia e Rugës së Kavajës. Bekimi predikon fenë Islame, atë që predikohet në Kuran dhe ndjek rrymën Myslimane Syni-te.

Në kuadër të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri konstatoi se:

*Së pari*, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, subjekti ankues, pavarësisht faktit që e provon atë, nuk ka dhënë asnjë shpjegim apo sqaruar rrethana, me fakte e prova se si ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme nga ana DPPSH dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, apo se si ky trajtim lidhet me bindjet e tij fetare. Në lidhje me këtë moment, subjekti ankues parashton në ankesë se, është diskriminuar që në fazat e para nga organi i prokurorisë.

<sup>3</sup> Vendimi nr. 26, datë 20.05.2020 “Për pushimin e çështjes penale në ngarkim të B. P” të Gjykatës së Posaçme për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar të Shkallës së Parë.

<sup>4</sup> Vendim i cili ka marrë formë të prerë, me datë 05.06.2020.

<sup>5</sup> <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”<sup>6</sup>.*

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të ndrejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të bindjeve fetare, të pretenduar nga ankuesi, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga

<sup>6</sup> Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese.

shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkaku të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve fetare, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person ka bindje fetare të caktuara, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjeve fetare, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi janë bindjet fetare të ankuesit.

Pala ankuese nuk parashton fakte apo rrethana nga të cilat mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucioneve kundër të cilave ka paraqitur ankesën, që të jenë motivuar nga bindjet fetare të ankuesit. Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Në dukje, prezumimi i ankuesit për diskriminim lidhet me situatën e tij gjyqësore, si person i cili ka qenë nën hetim nga organet përkatëse hetimore dhe për të cilin janë zhvilluar procese gjyqësore, të dhëna këto që sipas pretendimit të tij mbahen ende në sistemin TIMS gjatë ushtrimit të kontrollit kufitar. Parë në këtë këndvështrim, pretendimet e ankuesit për kontrollet në pikat kufitare, lidhen me situatën e tij gjyqësore dhe jo me bindjet e tij fetare.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ..... ç) .....nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

*Së dyti*, Komisioneri vëren se, *prima facie*, mbajtja e kësaj të dhëne të pretenduar nga ankuesi, në sistem nga ana e DPPSH, (e dhënë që lidhet me faktin e procedimit të ankuesit, por të papërmbyllur me një vendim fajësie ndaj personit), kur personi nuk rezulton i dënuar nga gjykata për asnjë vepër penale, mund të krijojë premisa për paragjykim të tij nga ana e punonjësit të pikave kufitare, duke bërë që ai t’i nënshtrohet një kontrolli të imtësishëm në vijën e dytë të kontrollit në pikat kufitare kombëtare.

E drejta për mbrojtje të të dhënave personale bën pjesë tek të drejtat e mbrojtura sipas KEDNj-së. Në tërësinë e jurisprudencës së saj, GjEDNj-ja ka shqyrtuar temën e mbrojtjes së

të dhënave në shumë raste, në lidhje me mbrojtjen nga mbajtja e të dhënave nga ana e autoriteteve publike. Gjykata ka qartësuar se, KEDNJ, jo vetëm që detyron shtetet që të mos kryejnë veprime të cilat mund të shkelin këtë të drejtë të parashikuar nga Konventa, por i detyron në rrethana të caktuara, të garantojnë në mënyrë aktive respektimin e efektshëm të jetës private dhe familjare.

Konventa 108 “*Konventa për Mbrojtjen e Personave nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale*”,<sup>7</sup> zbatohet për të gjitha përpunimet e të dhënave personale, që kryhen si nga sektori privat ashtu edhe nga ai publik, duke përfshirë edhe përpunimet që kryejnë autoritetet gjyqësore dhe ato të policisë. Ajo mbron personat nga abuzimet që mund të ndodhin gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale dhe në të njëjtën kohë synon të rregullojë qarkullimin ndërkufitar të të dhënave personale. Sa i përket mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale, parimet e përcaktuara në Konventë kanë të bëjnë veçanërisht me mbledhjen dhe përpunimin automatik të të dhënave në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, ruajtjen për qëllime legjitime të përcaktuara dhe jo për qëllime që nuk përputhen me këto të fundit e as të mos ruhen për një kohë më të gjatë se sa është e nevojshme. Këto parime kanë të bëjnë edhe me cilësinë e të dhënave, veçanërisht sa i takon faktit se ato duhet të jenë të përshtatshme, të rëndësishme, jo të tepërta (parimi i proporcionalitetit) dhe të sakta.

Përveç garancive që ofron në lidhje me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, në mungesë të garancive të duhura ligjore, Konventa ndalon përpunimin e të dhënave “sensitive”, sikundër janë raca, mendimet politike, të dhënat në lidhje me shëndetin, bindjet fetare, jetën seksuale dhe të dhënat gjyqësore të një personi.

Konventa sanksionon ndër të tjera, edhe të drejtën e personit për t’u informuar në lidhje me të dhënat e ruajtura të cilat kanë të bëjnë me të dhe aty ku është e nevojshme, të kërkojë korrigjimin e tyre. Kufizimet e të drejtave të parashtruara në Konventë, janë të mundshme vetëm kur prevalojnë interesa më të mëdha, si për shembull siguria ose mbrojtja kombëtare dhe të dhënat duhet të fshihen, kur ato qëllime janë përmbushur.

Tek çështja *S. dhe Marper*, GjEDNJ-ja doli në përfundimin se parimet thelbësore të instrumenteve përkatëse të Këshillit të Evropës dhe legjislacioni e praktika në fuqi e Palëve të tjera Kontraktuese, përcaktojnë që ruajtja e të dhënave të jetë proporcionale në raport me qëllimin e mbledhjes dhe e kufizuar në kohë, sidomos në sektorin e policisë. Sidoqoftë, kufizimi i kohëzgjatjes së ruajtjes së të dhënave personale gjen zbatim vetëm për të dhënat të cilat ruhen në një formë e cila mundëson identifikimin e subjekteve të të dhënave. Për këtë, ruajtja e ligjshme e të dhënave të cilat nuk nevojiten më, mund të bëhet duke anonimizuar ose pseudonimizuar të dhënat.

GJEDNJ, tek çështja *Cemalettin Canli kundër Turqisë*, gjeti shkelje të KEDNJ-së, lidhur me një raport policor të pasaktë në kuadër të një procedimi penal. Ankuesi ishte përfshirë dy herë

---

<sup>7</sup> KiE, Konventa për Mbrojtjen e Personave nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, Këshilli i Evropës, STCE nr. 108, 1981.

në një procedim penal, për shkak se dyshohej se ishte anëtarësuar në organizata të jashtëligjshme, por nuk ishte dënuar kurrë.

GjEDNj-ja<sup>8</sup> vendosi se mbajtja në mënyrë të përgjithshme dhe pa dallim e të dhënave personale, pa afate kohore dhe kur individët e liruar kishin mundësi të kufizuar të kërkonin fshirjen e tyre, përbënte një cënim jo proporcional të të drejtës së ankuesit për respektim të jetës private, duke u shprehur ndër të tjera se: *“Çdo person duhet të ketë mundësi të ushtrojë të drejtën për akses në të dhënat në lidhje me të, të cilat janë objekt përpunimi, me qëllim që të verifikojë saktësinë e të dhënave dhe ligjshmërinë e përpunimit. Në përputhje me këto parime, subjektet e të dhënave duhet të gëzojnë të drejtën sipas legjislacionit kombëtar, për të kërkuar nga kontrolluesi korigjimin, fshirjen apo bllokimin e të dhënave të tyre, nëse mendojnë se përpunimi i tyre nuk respekton dispozitat e Direktivës, sidomos për shkak të natyrës së pasaktë apo të mangët të të dhënave”*.

Komisioneri në praktikën e tij, në çështje të ngjashme me çështjen objekt gjykimi<sup>9</sup>, ka vlerësuar se, e drejta për mbrojtje të të dhënave personale, bën pjesë në kompetencat lëndore të institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDHP).

Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, në nenin 1, të tij, ka përcaktuar se: *“Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale”*.

Nenet 13<sup>10</sup> dhe 19<sup>11</sup>, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, të ndryshuar, kanë përcaktuar shprehimisht se:

*“Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin korigjimin ose fshirjen e të dhënave, pa pagesë kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen bllokimit e korigjimit apo të fshirjes.*

*Kontrolluesi kryen vetë ose me kërkesë të subjektit të të dhënave bllokimin korigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, kur vëren se janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së subjektit të të dhënave, informon subjektin e të dhënave për kryerjen apo moskryerjen bllokimit e korigjimit ose të fshirjes. Kontrolluesi informon marrësin e të*

<sup>8</sup> GjEDNj, S. dhe Marper kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 30562/04 dhe 30566/04, 4 dhjetor 2008, parag. 119 dhe 125

<sup>9</sup> Vendimi i KMD-së, me nr. 54, datë 18.03.2022: <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/03/Vendim-nr.-54-date-18.03.2022-A.B-kunder-DKM-DPPSH-2-Mosdiskriminim.pdf>

<sup>10</sup> Pikat 1 dhe 2, të tij.

<sup>11</sup> Pikat 1,23, të tij.

*dhënave personale për korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, të transmetuara para korrigjimit apo fshirjes”.*

Neni 29, pika 1, e këtij Ligji, ka përcaktuar se: *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti përgjegjës, i pavarur që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale, dhe të drejtën e informimit duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.*

Kompetencat e KDIMDHP janë parashikuar në nenin 30, 31, 31/1, të Ligjit, si më poshtë citohet:

*“ Komisioneri ka këto të drejta:*

*a) kryen hetim administrativ dhe ka të drejtën e aksesit në përpunimet e të dhënave personale, si dhe ka të drejtë të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të mbikëqyrjes;*

*b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale;*

*c) jep udhëzime përpara se përpunimet të kryhen dhe siguron publikimin e tyre.*

*2. Komisioneri, në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.*

*2/1. Për rastet që shkelja përbën vepër penale, bën kallëzimin përkatës.*

*“1. Komisioneri është përgjegjës për:*

*.....*

*e) kontrollimin e përpunimit të të dhënave, në përputhje me ligjin, kryesisht ose me kërkesë të një personi edhe kur një përpunim i tillë është i përjashtuar nga e drejta e informacionit dhe vënien në dijeni të personit se kontrolli është kryer, si dhe verifikimin nëse procesi është i ligjshëm ose jo;*

*“ë) zgjidhjen e ankimeve të subjektit të të dhënave për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tij, për përpunimet e të dhënave personale dhe vënien e tij në dijeni për zgjidhjen e ankesës së paraqitur”.*

*“Përveç përgjegjësive të parashikuara në nenin 31, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ushtron edhe kompetencat e mëposhtme në fushën e së drejtës së informimit:*

*a) shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin “Për të drejtën e informimit;*

*b) shqyrton ankesat e personave në lidhje me funksionimin e programeve të transparencës në autoritetet publike;*

*c) kryen hetimet e nevojshme administrative gjatë ushtrimit të kompetencave të tij;*

*ç) njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas ligjit për të drejtën e informimit apo që lidhen me çështjen në shqyrtim, duke përfshirë edhe*



informacionet e klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e “sekretit shtetëror”, sipas legjislacionit në fuqi;

d) vendos sanksione administrative sipas parashikimeve të ligjit për të drejtën e informimit;

dh) nxit parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit;

e) monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit;

ë) kryen sondazhe në lidhje me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtën e informimit;

f) bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës;

g) me kërkesë të gjykatës që shqyrton çështjen, parashton mendim me shkrim për çfarëdo çështjeje që lidhet me të drejtën e informimit”.

Ligji nr. 71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, në nenin 20, pika 3<sup>12</sup> e tij, ka përcaktuar se, rregullat për administrimin e të dhënave të grumbulluara nga zbatimi i këtij ligji përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Bazuar në sa më lart, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kanë nxjerrë Udhëzimin e Përbashkët me nr. 515, datë 27.09.2016<sup>13</sup> “Për Përpunimin e të Dhënave Personale nga Rojet Kufitare”.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi bazuar në:

- Kompetencat e sanksionuara nga ligji nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar<sup>14</sup>” dhe aktin nënligjor në zbatim të tij<sup>15</sup>, Udhëzimit të Përbashkët me nr. 515, datë 27.09.2016 “Për Përpunimin e të Dhënave Personale nga Rojet Kufitare”, të Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Faktin që KDIMDHP, është insitucioni që ka kompetencën ligjore për kontrollin, analizimin dhe vlerësimin nëse të dhënat personale mbahen në mënyrë ligjore e të justifikuar nga subjektet kontrolluese, DKM/DPPSH, në rastin konkret përse i takon mbajtjes të të dhënave të pretenduara nga ana e subjektit ankues;

gjykon se, nuk mund të vlerësojë faktin nëse mbajtja e të dhënave të pretenduara nga subjekti ankues, të cilat lidhen me procesin penal të iniciuar kundrejt tij (pavarësisht faktit se ka

<sup>12</sup> Kreu III, i këtij ligji “Administrimi i të Dhënave Personale”.

<sup>13</sup> Hyrë në fuqi me datë 29.09.2016.

<sup>14</sup> Neni 20/3 i ligjit: “Rregullat për administrimin e të dhënave të grumbulluara nga zbatimi i këtij ligji përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

<sup>15</sup> Në zbatim të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kanë nxjerrë Udhëzimin e Përbashkët me nr. 515, datë 27.09.2016<sup>15</sup> “Për Përpunimin e të Dhënave Personale nga Rojet Kufitare”.

pushuar çështja penale në ngarkim të tij dhe ai rezulton i padënuar) për subjektin ankues, në sistemin TIMS, është e ligjshme apo jo, përsa kohë një vlerësim i tillë është një e drejtë dhe detyrim ligjor që i atribuohet një institucioni tjetër, siç është KDIMDHP.

Në këto kushte, bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se një shqyrtim i tillë, nuk bën pjesë në kompetencat lëndore dhe fushën e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për pasojë, ky kërkim i ankuesit nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e tij. Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, i cili citon se: "*Ankesa nuk pranohet nëse përbën abuzim me të drejtën e ankimit para Komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji*", ankesa kundër DPPSH nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Së treti, sa i takon pretendimit të ankuesit se është diskriminuar nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, bazuar në arsyetimin vijues:

Çdo pretendim i ankuesit që lidhet me sjelljet, veprimet apo mosveprimin e organeve shtetërore të tilla si Prokuroria, në rastin konkret, të cilat ngrihen në kuadër të një procesi hetimor a gjyqësor, bëhet pranë organeve kompetente të drejtësisë si, gjykatat respektive apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë, dhe shqyrtimi i tyre është jashtë kompetencave të KMD-së, dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj<sup>16</sup>.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, përcaktohet se: "*4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) .....është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.*". Mungesa e kompetencës së Komisionerit për shqyrtimin e këtij pretendimi të paraqitur nga ankuesi, e bën ankesën të papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Edhe nëse do të merrnim të mirëqenë se, Komisioneri ka kompetencën për të shqyrtuar veprimet apo mosveprimet e organit të Prokurorisë, momenti i pretenduar për sjellje e veprime diskriminuese nga ana e Prokurorisë kundrejt tij, lidhet me veprimet e para të saj në kuadër të fillimit të procesit penal kundër tij, proces i cili daton në vitin 2015 dhe ka përfunduar në vitin 2020.

Referuar nenit 33/4/dh, të ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, i cili citon se: "*Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese*", ankesa përsëri nuk do të mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i

---

<sup>16</sup> Për analogji citojmë Vendimin nr. 81, datë 26.04.2022, të KMD-së.

nënshtrohej procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj, pasi është në tejkalim të afateve ligjore të përcaktuara në LMD.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç/dh, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues B. P, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**